



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 2, Datë 21.07.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR “RIKUALIFIKIMIN URBAN TË SHESHIT “AVNI RUSTEMI” DHE PAZARIT TË RI”, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, nenit 19 të Vendimit nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, Vendimit nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Kulturës, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për “Rikualifikimin urban të sheshit “Avni Rustemi” dhe Pazarit të Ri”, Bashkia Tiranë, me subjekt aplikues “Fondacionin Amerikano-Shqiptar të Zhvillimit” dhe kërkesë të Ministrisë së Kulturës.
2. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
 - a. Dokumenti i Rregullores së Lejes së Ndërtimit;
 - b. Harta e Planvendosjes së Strukturave.
3. Ngarkohet Ministria e Kulturës për lëshimin e Formularit të Lejes së Ndërtimit.
4. Ngarkohet Ministria e Kulturës dhe Njësia e Qeverisjes Vendore për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETARE E KKT

EGLANTINA GJERMI

MINISTËR I ZHVILLIMIT URBAN



MIRELA KUMBARO

MINISTËR I KULTURËS



SEKRETARE E KKT

ADELINA GREÇA

Adelina Greça



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT